

**STUART MANN**  
**HISTORIANI I PARË ANGLISHT I LETËRSISË SHQIPTARE**

nga  
Robert Elsie

Para pak dhjetëvjeçarëve, letërsia shqiptare ishte gati e panjohur në botë. Në një farë mënyre mund të themi se është kështu edhe sot. Interesimi im që prej fillimi gjithmonë ka qenë që kjo letërsi të bëhet më e njohur, pra të përkthehen disa vepra kryesore anglisht në mënyrë që bota të di për çfarë mendojnë dhe çfarë ëndërrojnë shqiptarët. Por për të zgjedhur disa vepra për përkthim, duhet të dish diçka për zhvillimin historik të letërsisë shqiptare.

Kur fillova të interesohem jo vetëm për letërsinë shqiptare por edhe për historinë e saj, kishte në treg vetëm një vepër anglisht: *Albanian literature, an outline of prose, poetry and drama* (Letërsia shqiptare, një skicë e prozës, poezisë dhe dramës) nga Stuart Man (Mann). Ky libër 121-faqesh u botua në Londër në vitin 1955 dhe, kur e kërkoja, kishte dalë nga qarkullimi.

Për fatin tim, e veja e Stuart Man-it, Helen Man, nga krahina Bakingëmshër (Buckinghamshire) të Anglisë më dërgoi personalisht një ndër kopjet e fundit të këtij libri të rrallë. Libri i Man-it ishte i vogël por plot informacione që më zgjoi menjëherë interesimin. Del e qartë se Man-i kishte njohuri të drejtpërsëdrejta për zhvillimet e letërsisë shqiptare në vitet 20 dhe 30 si dhe një gjykim të qartë.

Si shpjegohet që një anglez në vitin 1955 të botonte një histori të letërsisë shqiptare në një kohë kur edhe shqip nuk ekzistonte një histori e mirëfilltë e tillë? Dhe kush ishte Stuart Man?

Stuart Man lindi në vitin 1905 në Notingëmshër (Nottinghamshire) dhe mbaroi studimet e gjermanishtes në Universitetin e Bristol-it në vitin 1927.

Në vitin 1929, një vit pas shpalljes së monarkisë së Zogut, Stuart Man udhëtoi për në Shqipëri ku qëndroi deri në vitin 1931 për të mësuar gjuhën shqipe dhe për t'u familiarizuar me kulturën shqiptare. Ishte i interesuar kryesisht për fonologjinë dhe për historinë e gjuhës. Më vonë, Man-i dha mësim të gjuhës angleze në Universitetin e Brnos të Çekosllovakisë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ai është kthyer në Angli ku punoi për Ministrinë e Informacionit dhe, pas luftës deri në vitin 1972, punoi për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Gjatë viteve të pensionit ai dha mësim të gjuhës shqipe në Universitetin e Londrës dhe vdiq në vitin 1986.

Ndër botimet kryesore të Man-it janë: *A short Albanian grammar* (Një gramatikë e shkurtër e shqipes), botuar në Londër në vitin 1932, *An historical Albanian-English dictionary* (Një fjalor historik shqip-anglisht) botuar në Londër në formën përfundimtare në vitin 1948, *English-Albanian dictionary* (Fjalor anglisht-shqip) botuar në Londër në vitin 1957 dhe ribotuar në Prishtinë në vitin 1966, dhe *An Albanian historical grammar* (Një gramatikë historike e shqipes) botuar në Hamburg në vitin 1977. Përveç kesaj, Man-i ishte autori i një serë artikujsh shkencorë, kryesisht për gjuhën dhe letërsinë shqiptare.

Në bibliotekën e Shkollës së Sllavistikës (SSEES) të Universitetit të Londrës ruhet edhe sot arkivi i Stuart Man-it me disa vepra të pabotuara. Ndër këto janë disa përkthime të letërsisë shqiptare: Ernest Koliqi, Teto Petro, Lumo Skendo, Thimi Mitko, Spiro Dine dhe Milto Sotir Gurra, si dhe një përshkrim i shkurtër për qëndrimin e tij në Shqipëri, i shkruar 40 vjet më vonë, me titullin *Albania then and now* (Shqipëria atëherë dhe sot).

Dëshiroj të ju jap disa informacione për këtë dokument të fundit, duke qenë se është një tekst i lezetshëm dhe me shumë humor, dhe veçanërisht duke qenë se, sa e di unë, kurrë më përpara nuk është botuar apo bërë i njohur.

Stuart Man erdhi në Shqipëri në vitin 1929 me një traget nga Brindisi. Kryeqyteti i ri i Shqipërisë, Tiranë, ishte akoma një fshat, siç thotë, pa kanalizim, pa ujë, pa gaz dhe pa mjetë të qarkullimit. Man-i gjeti një punë si mësues i anglishtes në shkollën e Fulcit, ku u dha mësim një serë personalitetesh shqiptare, duke përfshirë edhe kryeministrin e mëvonshëm komunist Mehmet Shehu:

*Kur erdha për të kërkuar punë, pyeta një çun për drejtorin. "There he is," tha djali anglisht. Drejtori ishte duke derdhur beton për themelet e konviktit të ri. "A doni dikë për mësimin e anglishtes?" pyeta unë. "Ndoshta," tha, "Mirë, dakord. Gjysmën e rrogës e keni nga ne, dhe gjysmën tjetër nga qeveria shqiptare." Pra, më mori persipër pa u interesuar fare për kualifikimin tim, dhe në fund të muajit, unë mora rrogën time me florí në dorë, monedhat më të rënda ari që kam patur ndonjëherë.*

Man-i ishte i habitur shumë nga infrastruktura e brishtë e kryeqytetit të mbretërisë së re. Për telefonin thotë:

*Kishte vetëm një linje që lidhte Tiranën me Durrësin dhe me botën e jashtme. Kishte edhe një për Shkodrën dhe një tjetër për në Jug. Duke qenë se shtyllat e telefonit ishin të shtrenjta dhe i duhej importuar nga jashtë, shqiptarët përdornin pemat e gjalla për këtë punë. Pasi u zhvishën nga gjethi çdo qind metër, pemat u lidhën me linjen telefonike. Por çdo pranverë kishte ndërprerje të rënda në lidhje sepse shtyllat e telefonit në Tiranë çelnin.*

Edhe për sistemin e energjisë elektrike ka një njoftim të lezetshëm. Energjia elektrike erdhi në Shqipëri në vitin 1926 nëpërmjet shkollës së Fulcit, për të cilën u importua një motor të tipit Petters nga Anglia. Man-i tregon kështu:

*U futën disa fuçi nafte të rëndë në bodrum të shkollës dhe mrekullia u bë. Kishtë dritë! Pas njëfarë kohe mrekullia e energjisë elektrike erdhi te veshi i Zogut. I mërzitur në pallatin e tij, ku rrinte duke pirë duhan dhe kafe, ai erdhi një ditë në shkollë për një vizitë. Ishte vonë dhe u hapën dritat. Rezultati i kësaj vizite ishte që u detyruam të shtronim një linjë nga shkolla për në pallatin e mbretit.*

Man-i banonte në një hotel i cili, siç tha, dispononte të vetmët dy banjo me vaskë në Tiranë. Është fjala me siguri për Hotelin Internacional në Tiranë, godina e bukur por e dëmtuar rëndë e të cilit qëndron për mrekulli edhe sot në rrugën Kajo Karafili prapa ambasadës së Selisë së Shenjtë. Ai thotë:

*Banjo duhej prenotuar dy jave më përpara dhe kushtoi një gjysmë koronë. Më thanë që nuk kishte mundësi që të përdor unë banjo sepse ishte e prenotuar për një muaj të tërë nga Kryeministri dhe kabineti i tij. Kështu mësova të lahem me një enë bakri në dhomën e fjetjes.*

Në katin e dytë të hotelit, mësuesi anglez pa diçka të habitshme. Një njeri i shkolluar me syzë shkruante një letër nga e djathta në të majtën. Ai e palosi, duartrokiti njëherë dhe ia dha zarfin një çuni. Ky njeri dinte të shkruante

*vetëm turqisht me shkronjat e vjetra arabe. Nuk dinte të shkruante shqip. Pas largimit të çunit unë e pyeta kush ishte. “Jam kryeministri” tha.*

Stuart Man përfundon kujtimet e shkurtra të tij, të shkruar në vitin 1970, kështu:

*Më vjen keq të them se kryeministri i tanishëm është një ish-nxënës imi. Atij i dhashë mësim kur kishte vetëm gjashtëmbëdhjetë vjeç. Qeveria e tij më ka ftuar dy herë për të vizituar Shqipërinë, duke paguar të gjitha shpenzimet, por unë nuk pranova, duke thënë që nuk kisha kohë. Kjo është pjesërisht e vërtetë. Por nuk është e vërteta e plotë.*

Ndoshta për këtë arsye Stuart Man, albanologu i shquar anglez, mbeti i papërmendur dhe pak i njohur në Shqipëri gjatë periudhës komuniste. Besoj që ka ardhur kohë që veprat e tij të njihen më mirë dhe që ai vetë të nderohet për ndihmesën e tij të madhe për njohjen e gjuhës dhe të letërsisë shqiptare.

[botuar në / published in: *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare: Punimet e Materialeve të Seminarit XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, gusht 2001 (Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë 2002), vëll. 2, f. 199-202.]